# DËSHMI ARKIVI

**A-452639**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Diaspora shqiptare mblidhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/diaspora-shqiptare-mblidhet-ne-times-square-ne-mbeshtetje-te-ish-kreve-te-uck-se-prefekti-i-tiranes-ndan-pamjet/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 14:45:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 14:43:12 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `34aa8fbc702ecdbd3bf7a7524853f121912788a094809ccca646cb8555355cb6` |
| TEKSTI | `e7530fda0dbafea63af88e343540a4bc1c62d3b9458a825689c0fa8b9a32242f` |
| PAMJA | `e548a17432a589f481b89e1483f308ffb43ee11b8e4ef1b5db1e414c4fb00bec` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `25969c2cbad4a5f3f05fe22513a261549b4cea5fd4741d5f64a1489c0d61131e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/25969c2cbad4a5f3f05fe22513a261549b4cea5fd4741d5f64a1489c0d61131e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Diaspora shqiptare mblidhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet

17 Shtator 2026 | 16:43

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë nga Dhomat e Specializuara në Hagë, me të cilin ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u dënuan me gjithsej 81 vite burgim, mbështetja për ta është shprehur edhe jashtë Kosovës.

Mbrëmjen e kaluar, shqiptarë të diasporës u mblodhën në Times Square, në zemër të Nju Jorkut, në një protestë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. Pjesëmarrësit shprehën kundërshtimin e tyre ndaj aktgjykimit dhe theksuan rëndësinë që, sipas tyre, ka ruajtja e kujtesës për luftën e Kosovës dhe sakrificën e popullit.

Pamje nga tubimi në Nju Jork ka publikuar në rrjetet sociale edhe prefekti i Tiranës, Shkëlqim Hajdari.

Në reagimin e tij, Hajdari tha se diaspora shqiptare u mblodh në Times Square për të shprehur mbështetjen për ish-krerët e UÇK-së, duke e cilësuar aktgjykimin ndaj tyre si të padrejtë.

“Dje në Manhattan, në Times Square! TË GJITHË BASHKË, PËR NJË QËLLIM — LIRI PËR ÇLIRIMTARËT!

Mbrëmë, diaspora shqiptare u mblodh si një trup i vetëm, me një zë dhe me një qëllim: të qëndrojmë pranë vëllezërve tanë, ish-krerëve të UÇK-së, të cilët ne besojmë se janë dënuar padrejtësisht.

Pavarësisht se nga cila trevë shqiptare vijmë, sot na bashkon Kosova, na bashkon historia jonë dhe respekti për ata që luftuan dhe sakrifikuan për lirinë e saj.

Nga Amerika e kudo në diasporë, mesazhi ynë është i qartë: nuk i harrojmë çlirimtarët tanë dhe nuk harrojmë sakrificën e popullit të Kosovës.

Së bashku kemi qenë në ditët më të vështira dhe së bashku do të vazhdojmë të qëndrojmë edhe sot — si vëllezër e motra, si një diasporë dhe si një komb.

LIRI • DREJTËSI • DINJITET

Së bashku për vëllezërit tanë. Së bashku për çlirimtarët”, shkroi Hajdari në Facebook.

## LAJMI I FUNDIT

16:22 **U fut në det për t’u larë, i moshuari nga Kosova humb jetën në Velipojë**

16:10 **Biblioteka e fshehur për 15 vjet në Siri, Abu Bilal shemb murin dhe rikthen librat në dritë**

16:06 **Erdogan kërkon një mandat të ri presidencial? Çfarë thotë këshilltari i tij për zgjedhjet e parakohshme**

16:02 **65 mijë kërkesa për dëmet në Ukrainë, Gogu: Shqipëria ratifikon mekanizmin e kompensimit**

15:48 **Nëntë gra të vdekura në dy muaj, frikë për një vrasës serial në Afrikën e Jugut**

15:27 **Pas vendimit të Hagës, bashkëshortja e Rexhep Selimit publikon foton me fëmijët: Gjithmonë krenarë**



Se bashku për vëllezërit tanë. Se bashku për çlirimtarët", shkroi Hajdari në Facebook.

🇽🇰🇺🇸 Protests in support of former KLA leaders held in Times Square in New York. https://t.co/MB8xh2E50g

— kos_data (@kos_data) September 17, 2026

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJMI I FUNDIT | VENDI

### U fut në det për t'u larë, i moshuari nga Kosova humb jetën në Velipojë

Një 82-vjeçar nga Kosova ka humbur jetën këtë të enjte në plazhin e Velipojës. Sipas informacionit paraprak të policisë, rreth orës 15:30, në zonën e...

16:22 | 17/09/2026

AKTUALITET | LAJMI I FUNDIT | VENDI

### Shpallet në kërkim 41-vjeçari që ndryshoi emrin me dokument fals, pezullohen dy punonjës të Gjendjes Civile

Sektori për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, në drejtimin e Prokurorisë, ka finalizuar operacionin e koduar "Identiteti", në kuadër të të cilit është ekzekutuar...

14:58 | 17/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Theu masën e "arrestit në shtëpi" dhe vodhi 16 lokale, arrestohet 34-vjeçari në Tiranë i ndaluar për të njëjtën vepër

Një 34-vjeçar është vënë në pranga nga policia e Tiranës këtë të enjte pasi është autori i 16 rasteve të vjedhjes të lokaleve në kryeqytet,...

14:05 | 17/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.